



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:020236

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753474

KE.nr.1123/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit Komuna e Drenasit, me seli në Drenas, kundër të paditurit Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës me datën 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE, për të vendosur sipas padisë së paditësit Komuna e Drenasit, me numër të lëndës KE.nr.1123/22 (C.nr.348/2021;2021:020236) të datës 03.02.2021, kundër të paditurit Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, me objekt kontesti kompensim dëmi.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Komuna e Drenasit, me datë 03.02.2021, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi kundër të paditurit Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit ashtu që të detyrohet i padituri që paditësit t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata gjatë shqyrtimit të padisë si dhe shkresave të lëndës në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Sipas nenit 2 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale është përcaktuar shprehimisht se: *“Ky ligj zbatohet ndaj të gjithë personave juridikë dhe fizikë, vendorë dhe të huaj përfshirë shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës të cilët kanë konteste tregtare ndërmjet tyre”*, ndërsa sipas nenit 3, pika 1.11, kontesti tregtar është definuar si: *“çdo kontest mes shoqërive tregtare, shoqërive tregtare dhe subjekteve publike dhe të gjitha konflikteve administrative të shoqërisë tregtare, siç përcaktohet në nenin 13 të këtij Ligji”*. Në anën tjetër, me nenin 13, paragrafi 1, pik 1.1 të të njëjtit ligj, përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*.

Meqenëse në rastin konkret çështja juridike zhvillohet në mes të paditësit Komuna e Drenasit dhe të paditurit Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, që të dyja institucione publike, ndërsa sipas dispozitave të cituara më lartë Gjykata Komerciale është e kompetencës lëndore për të gjykuar çështjet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate, ngase asnjëra nga palët nuk e ka cilësinë e shoqërisë tregtare dhe rrjedhimisht kjo çështje nuk përfaqëson çështje tregtare për vendosjen e së cilës do të ishte e kompetencës kjo gjykatë, dhe duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1123/22, datë 29.05.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate